


# Tax&Legal

Janar 2021  
January 2021

## *SPECIAL NEWS*



**Deloitte.**



● Ligji Fiskal Hidrokarbur

● Petroleum Fiscal Law

Duke filluar nga data 2 shkurt 2021, në Shqipëri do të zbatohet një legjislacion i ri që rregullon taksimin e sektorit hidrokarbur. Ligji nr. 153/2020 "Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur" (Ligji Fiskal Hidrokarbur ose LFH), miratuar nga parlamenti shqiptar më 17 dhjetor 2020 dhe botuar në fletoren zyrtare më 18 janar 2021, shfuqizon Ligjin ekzistues nr. 7811, të miratuar në 12 prill 1994, dhe përcakton regjimin e zbatueshëm fiskal për operacionet hidrokarbure në lidhje me:

- Tatimin mbi fitimin e operacioneve hidrokarbure;
- Rentën minerare; dhe
- Masën në të cilën një marrëveshje hidrokarbure mund të ndikojë në detyrimin për vendosjen e taksave e të tatimeve, si dhe taksat/tatimet vendore dhe kombëtare të zbatueshme.

### **Personat subjekt të LFH**

LFH zbatohet për personat juridikë që kryejnë operacione hidrokarbure në tokë (onshore), të autorizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për kërkimin dhe prodhimin e naftës. Një legjislacion i veçantë pritet të rregullojë regjimin fiskal të zbatueshëm për personat juridikë që kryejnë operacione hidrokarbure në det (offshore).

LFH zbatohet gjithashtu për personat që kryejnë operacione hidrokarbure në mënyrë direkte ose indirekte (referuar si "nënkontraktorë"), të cilët përmbushin një nga kriteret e mëposhtme:

New legislation regulating the taxation of the petroleum sector applies in Albania as from 2 February 2021. Law No. 153/2020 "On the fiscal regime in petroleum sector" (the Petroleum Fiscal Law or PFL), approved by the Albanian parliament on 17 December 2020 and published in the official gazette on 18 January 2021, repeals the existing Law No. 7811, enacted on 12 April 1994 and sets out the applicable taxation regime for petroleum operations with respect to:

- Profit tax on petroleum operations;
- Royalty tax; and
- The extent to which a petroleum agreement may affect the obligation to impose tax, as well as the applicable local and national taxes.

### **Entities subject to the PFL**

The PFL applies to legal persons that carry out onshore petroleum operations, authorized in compliance with the legislation in force for petroleum exploration and production. Separate legislation is expected to govern the tax regime applicable to legal persons that carry out offshore petroleum operations.

The PFL also applies to legal persons that directly or indirectly carry out petroleum operations (referred to as "subcontractors") fulfilling any of the following criteria:

- Nënkontraktori konsiderohet si “palë e lidhur” me kontraktorin në përputhje me përkufizimin e dhënë në Ligjin nr. 8438, datë 28 dhjetor 1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” (“Ligji i Përgjithshëm për Tatimin mbi të Ardhurat”);
- Nënkontraktori është në rolin e operatorit në lidhje me operacionet hidrokarbure dhe kryen aktivitete që janë thelbësore për operacionet hidrokarbure, të përcaktuara për qëllime të LFH si, aktivitete për të cilat shuma e faturuar nga nënkontraktori përfaqëson të paktën 25% të shumës totale të shpenzimeve për operacionet hidrokarbure të personit të autorizuar;
- Qëllimi kryesor i marrëveshjes me nënkontraktorin është shmangia nga nënkontraktori i zbatimit të LFH dhe përfitimi i normës tatimore preferenciale sipas Ligjit të Përgjithshëm për Tatimin mbi të Ardhurat.
- The subcontractor is considered a “related party” of the contractor in accordance with the definition in Law No. 8438, dated 28 December 1998, “On Income Tax” (the General Law on Income Tax);
- The subcontractor is an operator in respect of petroleum operations and conducts activities that are essential to petroleum operations, defined for the purpose of the PFL as activities for which the amounts invoiced by the subcontractor represent at least 25% of the total amount of petroleum operation expenses of the authorized person;
- The main purpose of the agreement concluded with the subcontractor is to enable the subcontractor to avoid the application of the PFL and to benefit from the preferential tax rate under the General Law on Income Tax.

### **Regjimi i përgjithshëm i tatimit mbi fitimin kundrejt regjimit fiskal hidrokarbur**

Personave që kryejnë operacione hidrokarbure u kërkohet të ndajnë dhe alokojnë të ardhurat dhe shpenzimet e tyre midis operacioneve hidrokarbure dhe operacioneve johidrokarbure, nëse ka. Fitimet e tatueshme që rrjedhin nga operacionet hidrokarbure llogariten si shumë totale e fitimeve të tatueshme nga secili prej operacioneve të veçanta hidrokarbure për këtë periudhë, duke përjashtuar humbjet, dhe janë subjekt i tatimit mbi fitimin hidrokarbur në normën 50%.

### **General profit tax regime versus petroleum profit tax regime**

Persons conducting petroleum operations are required to divide and attribute their income and expenses between petroleum operations and non-petroleum operations, if any. Taxable profits derived from petroleum operations are calculated as the aggregate of the taxable profits from separate petroleum operations for the period, excluding losses, and are subject to petroleum profit tax at 50%.

Fitimet e tatueshme që rezultojnë nga operacionet johidrokarbure taten me normën standarde të tatimit mbi fitimin prej 15% sipas regjimit të përgjithshëm të tatimit mbi fitimin në përputhje me Ligjin e Përgjithshëm për Tatimin mbi të Ardhurat (ose 0%, nëse kjo është e zbatueshme). Humbjet tatimore që rrjedhin nga operacionet johidrokarbure nuk mund të përdoren për të reduktuar fitimet e tatueshme që rrjedhin nga operacionet hidrokarbure dhe anasjelltas.

### **Operacionet e veçanta hidrokarbure**

Operacionet e veçanta hidrokarbure konsistojnë në të gjithë ato operacione që i përkasin një të drejte hidrokarbure specifike. LFH paraqet rregulla specifike për përcaktimin e operacioneve hidrokarbure të veçanta, në varësi të zonave të kontratës si dhe zonave të zhvillimit dhe prodhimit. Parashikime të mëtejshme pritet të paraqiten në një udhëzim të përbashkët të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë të Energjisë dhe Industrisë, i cili pritet të publikohet në fillim të muajit maj 2021.

Secili operacion i veçantë hidrokarbur cilësohet si një biznes i pavarur. Për secilin operacion hidrokarbur të veçantë, personi duhet të mbajë të dhëna financiare të ndara si dhe duhet të ndajë përlogaritjet e fitimit të tatueshëm, humbjeve dhe tatimit mbi fitimin hidrokarbur.

Humbjet e lejuara nga një operacion i veçantë hidrokarbur nuk mund të përdoren për të reduktuar fitimet e tatueshme të një operacioni tjetër hidrokarbur apo fitimet e tatueshme që rrjedhin nga operacionet johidrokarbure.

Taxable profits derived from any non-petroleum operations are taxed at the standard profit tax rate of 15% under the general profit tax regime in accordance with the General Law on Income Tax (or 0%, if applicable). Tax losses derived from non-petroleum operations cannot be used to reduce taxable profits derived from petroleum operations, and vice-versa.

### **Separate petroleum operations**

Separate petroleum operations consist of all operations pertaining to an individual petroleum right. The PFL provides specific rules for determining separate petroleum operations depending on the contract areas, and development and production areas. Further provisions are expected to be included in a joint instruction of the Ministry of Finance and Economy and the Ministry of Energy and Industry, anticipated to be issued in early May 2021.

Each separate petroleum operation is considered as an independent business. For each separate petroleum operation the entity must keep discrete financial records and separate calculations of taxable profit, losses, and petroleum profit tax.

Allowable losses from one separate petroleum operation cannot be used to reduce taxable profits of another petroleum operation or taxable profits of non-petroleum operations.

Transaksionet ndërmjet një operacioni të veçantë hidrokarbur dhe operacioneve të tjera hidrokarbure/johidrokarbure të të njëjtit person trajtohen si transaksione të kontrolluara subjekt i rregullave të transferimit të çmimit.

### **Regjimi i tatimit mbi fitimin hidrokarbur**

Për çdo operacion të veçantë hidrokarbur njësia ekonomike duhet të përcaktojë:

- a. Të ardhurat që i atribuohen atij operacioni të veçantë hidrokarbur gjatë periudhës tatimore (A);
- b. Shpenzimet e zbritshme të atij operacioni gjatë periudhës tatimore (B); dhe
- c. Humbjet e lejuara të operacionit të mbartura nga periudhat e mëparshme tatimore (C).

Rregullat në vijim zbatohen nën regjimin e tatimit mbi fitimin hidrokarbur:

1. Fitimi i tatueshëm për periudhën tatimore llogaritet si  $[A - (B + C)]$  më lart, ku  $(B + C)$  nuk duhet të tejkalojë 85% të A. Kjo do të thotë që një njësi ekonomike do të paguajë tatim mbi fitimin hidrokarbur në normën 50%, mbi të paktën 15% të të ardhurave që i atribuohen një operacioni të veçantë hidrokarbur gjatë një periudhe tatimore;
2. Shpenzimet e zbritshme të periudhës tatimore (B), zbriten përpara çdo humbje të mbartur (C);

Transactions between a separate petroleum operation and other petroleum and/or non-petroleum operations of the same person are treated as controlled transactions subject to the transfer pricing rules.

### **Petroleum profit tax regime**

For each separate petroleum operation the entity must determine:

- a. The income attributable to that separate petroleum operation during the tax period (A);
- b. The deductible expenses of that operation during the tax period (B); and
- c. Allowable losses for that operation brought forward from previous tax periods (C).

The following rules then apply under the petroleum profit tax regime:

1. The taxable profit for the tax period is calculated as  $[A - (B + C)]$ , where  $(B + C)$  is capped at 85% of A. This means that an entity will pay petroleum profit tax at 50% on at least 15% of the income attributable to a separate petroleum operation during a tax period;
2. The deductible expenses of the tax period (B) are deducted before any allowable losses brought forward (C);

3. Kur shpenzimet e zbritshme të periudhës tatimore (B) janë më të larta se 85% e të ardhurave (A), teprica trajtohet si një humbje e lejueshme dhe mbartet e eventualisht zbritet në një periudhë të ardhshme tatimore (si C e asaj periudhe të ardhshme); dhe
4. Humbja e lejuar e një periudhe tatimore mund të mbartet për një kohë të pacaktuar, deri sa të përdoret për të reduktuar të ardhurat e një periudhe të ardhshme tatimore.

3. Where the deductible expenses of the tax period (B) exceed 85% of the income (A), the excess is treated as an allowable loss and is carried forward and eventually deducted in a future tax period (as C of that future period); and
4. The allowable loss of a tax period may be carried forward indefinitely, until used to reduce the income of a future tax period.

### **Përcaktimi i të ardhurave (A)**

Të ardhurat e një personi nga një operacion i veçantë hidrokarbur për një periudhë tatimore përfshijnë totalin e shumave të mëposhtme bruto:

- Vlera e tregut e hidrokarbureve të shitura gjatë asaj periudhe nga operacioni;
- Shumat bruto që realizohen gjatë periudhës, nga heqja dorë ose nga përdorimi i aktiveve të tjera afatshkurtra ose afatgjata të operacionit;
- Tarifat ose shumat e tjera të realizuara gjatë periudhës nga operacioni, duke përfshirë të ardhurat nga ofrimi i shërbimeve ose informacionit gjatë kryerjes së operacionit;
- Kompensimet dhe të ardhurat nga sigurimet të marra gjatë periudhës në lidhje me operacionin; dhe
- Tepricat në një fond rehabilitimi siç përcaktohen nga LFH.

### **Definition of income (A)**

Income from a separate petroleum operation of an entity for a tax period includes the aggregate of the following gross amounts:

- The market value of petroleum sold during the period from the operation;
- The gross amounts derived during the period from the disposal or use of other current or noncurrent assets of the operation;
- Fees or other amounts derived during the period from the operation, including income from the provision of services or information during the conduct of the operation;
- Compensation and insurance proceeds derived during the period in respect of the operation; and
- A surplus in a rehabilitation fund as indicated by the PFL.

Të mëposhtmet nuk përfshihen si të ardhura nga një operacion i veçantë hidrokarbur:

- Interesat dhe fitime të tjera financiare; dhe
- Pagesat për transferimin e së drejtës hidrokarbure.

### **Përcaktimi i shpenzimeve të zbritshme (B)**

Një shpenzim i një njësie ekonomike nga një operacion i veçantë hidrokarbur për një periudhë tatimore është i zbritshëm nëse plotëson të gjitha kriteret e mëposhtme, pra nëse shpenzimi:

- Është kryer nga njësia ekonomike gjatë periudhës dhe është drejtpërdrejt i lidhur me kryerjen e operacionit;
- Është konsistent me marrëveshjen hidrokarbure dhe praktikën më të mirë ndërkombëtare në industrinë hidrokarbure;
- Nuk është i përfshirë në listën e shpenzimeve të pazbritshme të përcaktuara nga LFH; dhe
- Është i përfshirë në atë çfarë duket të jetë një listë shteruese e shpenzimeve të zbritshme të parashikuara nga LFH.

Një shpenzim mund të kualifikohet si shpenzim i zbritshëm, qoftë ky shpenzim i një natyre operacionale apo kapitale.

The following are not included as income from a separate petroleum operation:

- Interest and other financial gains; and
- Payments for the transfer of the petroleum right.

### **Definition of deductible expenses (B)**

Expenses from a separate petroleum operation of an entity for a tax period are deductible where the expense meets all of the following criteria, namely that it is:

- Incurred by the entity during the period and is directly related to the conduct of the operation;
- Consistent with the petroleum agreement and best international oilfield practices;
- Not included in the list of nondeductible expenses provided by the PFL; and
- Included in what seems to be an exhaustive list of deductible expenses provided by the PFL.

An expense may qualify as a deductible expense whether it is of an operating or capital nature.



Lista e shpenzimeve të pazbritshme sipas LFH përfshin ndër të tjera:

- Amortizimin;
- Interesin, kostot financiare dhe kostot e shkaktuara në lidhje me instrumentet financiare;
- Pagesat e lidhura me rezultatin;
- Kostot për marrjen, mbajtjen, përmirësimin, mbrojtjen ose transferimin e së drejtës hidrokarbure, përfshirë çdo pagesë bonusi të kryer në lidhje me të drejtën;
- Pagesat për të siguruar pjesëmarrje në fitimet, faturimet ose shpenzimet e operacioneve hidrokarbure ose johidrokarbure; dhe
- Lista e shpenzimeve të panjohura që parashikon Ligji i Përgjithshëm për Tatimin mbi të Ardhurat, me disa përjashtime.

Kur personi që kryen një operacion të veçantë hidrokarbur pagan një palë të lidhur për aktivet, shërbimet ose mjete të tjera të dhëna për operacionin, çdo zbritje e pretenduar nga personi kufizohet në "shumën pa fitim", pra në koston faktike të ndeshur nga pala e lidhur për ofrimin e aktiveve, shërbimeve apo faciliteteve.

### **Deklarata e tatimit mbi fitimin hidrokarbur**

Personat që kryejnë operacione hidrokarbure duhet të dorëzojnë deklaratat të veçanta tatimore për operacionet johidrokarbure dhe operacionet hidrokarbure deri më 31 mars të vitit pasardhës. Fitimet e tatueshme për çdo operacion hidrokarbur duhet të raportohen veçmas.

The list of nondeductible expenses in the PFL includes:

- Depreciation;
- Interest, financial costs, and other costs incurred with respect to financial instruments;
- "Overriding" royalties;
- Costs of acquiring, holding, improving, defending, or disposing of a petroleum right, including any bonus payments made in respect of the right;
- Payments to acquire an interest in the profits, receipts, or expenditure of petroleum operations or non-petroleum operations; and
- The list of nondeductible expenses provided by the General Law on Income Tax, with certain exceptions.

Where a person conducting a separate petroleum operation pays a related party for assets, services, or other facilities supplied to the operation, any deduction claimed is limited to the "no profit" amount, i.e., the actual costs incurred by the related party in providing the assets, services, or facilities.

### **Petroleum profit tax declaration**

Persons conducting petroleum operations must file separate tax returns for non-petroleum operations and petroleum operations by 31 March of the following year. The taxable profits of each petroleum operation must be reported separately.

Tatimpaguesit mund të zgjedhin të bëjnë parapagime të tatimit mbi fitimin për operacionet hidrokARBURE dhe johidrokARBURE në këste tremujore ose mujore, sipas afateve dhe menyrës së përlogaritjes së parashikuar në nenin 30 të Ligjit të Përgjithshëm për Tatimin mbi të Ardhurat.

Të gjithë personat që kryejnë operacione hidrokARBURE duhet të regjistrojnë, raportojnë dhe paguajnë detyrimet e tyre tatimore në monedhën shqiptare Lek, në përputhje me parashikimet e Ligjit për Procedurat Tatimore.

## **E drejta hidrokARBURE**

Për qëllime të LFH, një e drejtë hidrokARBURE konsiderohet:

- Pasuri e paluajtshme, e ndarë nga të gjitha interesat e tjera në tokë në zonën e kontratës dhe nga të gjitha aktivet e tjera të përdorura në operacionet hidrokARBURE; dhe
- Aktiv i amortizueshëm, subjekt i normës vjetore të amortizimit prej 5%, në përputhje me nenin 22(3) të Ligjit të Përgjithshëm për Tatimin mbi të Ardhurat.

Metoda e alokimit dhe ndarjes së shpenzimeve për një të drejtë hidrokARBURE do të përcaktohet nëpërmjet një udhëzimi i cili pritet të publikohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë.

Blerja, mbajtja dhe heqja dorë nga një e drejtë hidrokARBURE nuk është pjesë e operacioneve hidrokARBURE.

Taxpayers may opt to make prepayments of profit tax on petroleum and non-petroleum operations in quarterly or monthly installments, subject to the deadlines and calculation methodology provided in article 30 of the General Law on Income Tax.

All persons conducting petroleum operations must register, report, and settle their tax liabilities in Albanian Lek, in compliance with the provisions of the Law on Tax Procedures.

## **Petroleum right**

For the purposes of the PFL, a petroleum right is considered to be:

- Immovable property, distinct from all other onshore interests within the contract's area and all other assets used in petroleum operations; and
- A depreciable asset, subject to annual depreciation at 5%, in accordance with article 22(3) of the General Law on Income Tax.

The expense allocation and attribution method for a petroleum right is to be determined through an instruction expected to be issued by the Minister of Finance and Economy.

The acquisition, holding, and disposal of a petroleum right is not part of petroleum operations.

Kjo e drejtë konsiderohet si pjesë e operacioneve johidrokarbure të mbajtësit dhe për të zbatohen dispozitat e Ligjit të Përgjithshëm për Tatimin mbi të Ardhurat. Sidoqoftë, sipas LFH, heqja dorë nga e gjithë ose një pjese e një të drejte hidrokarbure krijon pasoja tatimore si për operacionet hidrokarbure ashtu dhe për operacionet johidrokarbure të personit që heq dorë, bazuar në disa konsiderata dhe kritere të përcaktuara në LFH.

### **Marrëveshjet Hidrokarbure**

Në përputhje me nenin 17 të LFH-së, marrëveshja hidrokarbure ose ndryshimet në këtë marrëveshje nuk kanë ndikim në zbatimin e një ligji fiskal (duke përfshirë LFH-në), me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 17 ose në ndonjë dispozitë tjetër të legjislacionit fiskal (duke përfshirë LFH-në).

Nga ana tjetër, paragrafi 3 i nenit 17 parashikon se në rast të një marrëveshje hidrokarbure, ose të një ndryshimi në marrëveshje të lidhur para hyrjes në fuqi të LFH-së, autoritetet tatimore do të zbatojnë legjislacionin fiskal pas marrjes në konsideratë të çdo mbrojtjeje specifike ose përjashtimi fiskal të parashikuar në marrëveshje. Shprehja "marrje në konsideratë" është e paqartë lidhur me përparësinë që marrëveshja hidrokarbure duhet të ketë mbi dispozitat e LFH-së, duke marrë parasysh se kjo shprehje në kuptimin gjuhësor të saj jo domodoshmërisht nënkupton efekt mbizotërues "detyrues", dhe kjo krijon kështu pasiguri për operatorët aktualë në sektorin e hidrokarbureve.

The right is accounted for as part of the holder's non-petroleum operations and the provisions of the General Law on Income Tax apply. However, under the PFL, the disposal of all or part of a petroleum right gives rise to tax consequences for both petroleum and non-petroleum operations of the person making the disposal, based on certain considerations and criteria determined in the PFL.

### **Petroleum agreements**

In accordance with article 17 of the PFL, a petroleum agreement or any amendments to such an agreement have no effect on the application of a fiscal law (including the PFL), unless otherwise provided for in article 17 or any other provision of the fiscal legislation (including the PFL).

On the other hand, paragraph 3 of article 17 provides that in case of a petroleum agreement or amendment to an agreement concluded prior to the entry into force of the PFL, the tax authorities will apply the fiscal legislation after taking into consideration any specific protection or fiscal exemption provided in the agreement. The wording "taking into consideration" is unclear with respect to the prevailing effects of a petroleum agreement over the provisions of the PFL, given that such wording does not necessarily mean any "mandatory" prevailing effect, and this creates uncertainties for current operators in the petroleum sector.

Pavarësisht nga sa më sipër, gjatë komisioneve parlamentare dhe fazave të ndryshme të miratimit të LFH-së, përfaqësuesit e Ministrisë së Financave vazhdimisht siguruan se qëllimi është që të gjitha dispozitat e marrëveshjeve hidrokarbure ekzistuese do të vazhdojnë të zbatohen siç është rënë dakord, pavarësisht nga çdo ndryshim që mund të kenë me dispozitat e ligjit të ri.

Për më tepër, paragrafi 4 i nenit 17 parashikon gjithashtu se në rast të një marrëveshje hidrokarbure, ose të një ndryshimi në marrëveshje të lidhur pas hyrjes në fuqi të këtij LFH-së, autoritetet tatimore do të zbatojnë legjislacionin fiskal pas marrjes në konsideratë të ndonjë klauzole të miratuar të stabilitetit të regjimit fiskal dhe lehtësimit nga taksat/tarifat vendore të parashikuara në marrëveshje.

Neni 20 i LFH-së parashikon se asnjë palë nuk mund të përfitojë dy herë. Një herë nga mbrojtja specifike e ofruar nga marrëveshja hidrokarbure, dhe në të njëjtën kohë, të përfitojë nga ndryshime të mundshme favorizuese që mund të ndodhin në legjislacionin fiskal.

LFH-ja ngarkon Këshillin e Ministrave, ministrin përgjegjës për financat dhe ministrin përgjegjës për hidrokarburet të nxjerrin legjislacionin plotësues respektiv të përcaktuar nga LFH-ja.

Notwithstanding the above, during parliamentary commissions and the various approval phases of the PFL, Ministry of Finance representatives consistently assured that the intention is that all provisions of existing petroleum agreements will continue to apply as agreed, despite any differences between the agreements and the provisions of the new law.

In addition, paragraph 4 of article 17 also provides that in case of a petroleum agreement or amendment to an agreement concluded after the entry into force of the PFL, the tax authorities will apply the fiscal legislation after taking into consideration any approved clause of the fiscal stability regime and relief from local taxes stipulated in the agreement.

Article 20 of the PFL provides that neither party may benefit simultaneously from both a specific protection in the petroleum agreement and benefits that may result from amendments to the fiscal legislation.

The PFL instructs the Council of Ministers, the minister responsible for finances, and the minister responsible for the petroleum sector to issue the respective supplementary legislation stipulated by the PFL.

## **Klauzola e miratuar e stabilitetit të regjimit fiskal**

Neni 18 i LFH-së përcakton se një klauzolë e stabilitetit fiskal mbron mbajtësin e së drejtës hidrokarbure nga:

- Vendosja e tatimeve/tarifave, etj., të reja diskriminuese nga qeveria, që nuk ekzistojnë në datën kur është lidhur marrëveshja;
- Ndryshime diskriminuese të tatimeve, tarifave, ose detyrimeve të tjera financiare ekzistuese, të vendosura nga qeveria; dhe
- Ndryshime që rezultojnë në dëmtimin material të mbajtësit të së drejtës që rrjedhin nga (i) renta minerare, (ii) norma e tatimit mbi fitimin ose tatimit në burim, ose (iii) tarifatat për importin e mallrave dhe shërbimeve, së bashku me ndryshimet në metodologjinë e llogaritjes së këtyre tatimeve, taksave dhe detyrimeve.

Një klauzolë e stabilitetit të regjimit fiskal ose çdo ndryshim i kësaj klauzole që parashikon mbrojtje pushon së aplikuari 12 vjet nga data e fillimit të prodhimit të përcaktuar në marrëveshjen hidrokarbure.

## **Kontrollet tatimore**

Për qëllime të administrimit dhe zbatimit të LFH, autoritetet tatimore dhe autoriteti rregullator kompetent do të bashkëpunojnë ngushtësisht dhe do të ndajnë informacione relevante duke ruajtur konfidencialitetin e të dhënave.

## **Fiscal stability regime clause**

Article 18 of the PFL stipulates that a fiscal stability regime clause protects a petroleum right holder against any:

- Imposition by the government of additional discriminatory taxes/duties, etc. not applicable at the time of the conclusion of the agreement;
- Discriminatory changes to existing taxes, duties, or other financial obligations imposed by the government; and
- Changes causing material damage to the right holder deriving from (i) royalty tax, (ii) the level of the profit tax or withholding tax, or (iii) tariffs for the import of goods and services, together with changes to the methodology of calculating these taxes and duties.

A fiscal stability regime clause or any amendments to such a clause providing any such protections will cease to apply 12 years after the date of commencement of production as provided in the petroleum agreement.

## **Tax audits**

For the purposes of administration and implementation of the PFL, tax authorities and the competent regulatory authority will cooperate closely and share relevant information whilst maintaining confidentiality.

Gjithashtu këto autoritete mund të kryejnë kontrolle të përbashkëta.

Autoritetet tatimore do të marrin në konsideratë elemente të caktuara të specifikuara nga autoriteti rregullator, siç janë: nëse një person kryen operacione hidrokarbure; vëllimet e naftës së nxjerrë; alokimi i të ardhurave dhe shpenzimeve në operacionet hidrokarbure; dhe nëse një person shkel kushtet e braktisjes, të rehabilitimit dhe të eliminimit të miratuar nga ministri përgjegjës për çështjet hidrokarbure. Ky fakt nuk i çliron ose kufizon autoritetet tatimore në detyrën e tyre për të mbledhur informacion dhe për të kontrolluar operacionet hidrokarbure për qëllime të legjislacionit fiskal.

### **Detyrimet shtesë të raportimit**

Mbajtësi i së drejtës hidrokarbure duhet të caktojë një punonjës me vjetërsi të mjaftueshme pune që të veprojë si një person kontakti me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN). Punonjësi duhet të dorëzojë në DPT dhe AKBN dy herë në vit raporte financiare, për secilin nga vitet e kohëzgjatjes së vlerësuar të së drejtës hidrokarbure, në bazë të formateve që do përcaktohen nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë. Mbajtësit e së drejtës hidrokarbure që nuk dorëzojnë këto parashikime financiare do të jenë subjekt i një penaliteti prej 100,000 Lekë për çdo shkelje.

They also may conduct joint audits.

The tax authorities will take into consideration certain elements specified by the regulatory authority, such as: whether a person conducts petroleum operations; volumes of extracted petroleum; allocation of revenues and expenses in petroleum operations; and whether a person breaches the terms of abandonment, rehabilitation, and decommissioning approved by the minister responsible for petroleum matters. This does not relieve the tax authorities from or restrict the tax authorities in their duty to collect information and audit petroleum operations for the purposes of the fiscal legislation.

### **Additional reporting obligations**

The petroleum right holder must permanently appoint a senior officer (employee) to act as a contact person for the General Tax Directorate (GTD) and the National Agency of Natural Resources (NANR). The senior officer must provide to the GTD and NANR twice a year, financial forecasts for each year of the estimated duration of the petroleum right, based on a template to be supplied by the Minister of Finance. Holders of petroleum rights that do not provide such financial forecasts will be subject to a penalty of ALL 100,000 for each breach.

## Deloitte Contacts

### **Olindo Shehu, CPA**

Partner | Tax & Legal Services  
Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Faik Konica", Ndërtesa nr.6  
Hyrja nr.7, 1010  
Tirana | Albania  
Mob: +355 68 60 33 116  
E-mail: [oshehu@deloitteCE.com](mailto:oshehu@deloitteCE.com)

### **Sabina Lalaj**

Local Legal Partner  
Deloitte Legal sh.p.k

Rr. "Faik Konica",  
Ndërtesa nr.6, Hyrja nr. 7  
1010, Tirana, Albania  
Mobile: + 355 68 37 33 130  
E-mail: [slalaj@deloitteCE.com](mailto:slalaj@deloitteCE.com)

### **Disclaimer:**

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

\*\*\*

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see [www.deloitte.com/al/about](http://www.deloitte.com/al/about) for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 312,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.